



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:117286
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05483869

KF.nr.733/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULLI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “Orange Fruits” SH.P.K. me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson SCLR Partners Prishtinës, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – rivlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, jashtë seance me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia KF.nr. 733/22 e datës 08.06.2022 e paditësit “Orange Fruits” SH.P.K. me seli në Ferizaj, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi.

A R S Y E T I M

Paditësi “Orange Fruits” SH.P.K. me seli në Ferizaj, ka iniciuar në këtë Gjykatë kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: Anulim Vendimi nr. 151/2022 i datës 27.04.2022, objekt kontesti – rivlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar.

Në bazë të nenit 253 par. 4 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63 të LKA-së, ligji nr. 03/L-202, paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjijt edhe vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësor për padi bazuar në vlerën e kontestit, ndërsa sipas paragrafit 5, të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar

nga ana e Gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Duke marr për bazë faktin si më lartë, është konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i këtu paditësit e ka pranuar vërejtjen për taksën gjyqësore për padi me datë 09.02.2024, mirëpo as brenda afatit ligjor, dhe as deri në nxjerrjen e këtij aktvendimi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi. Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë kontest tregtar administrativ komform nenit 253, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006 i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marr parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 253, paragrafi 4 dhe 5, të LPK-së i aplikuar përshtatshmërisht sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.733/22, datë 21.03.2024

G j y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.